



KOMISIONI RREGULLATOR  
I ENERGJETIKËS DHE I SHËRBIMEVE TË  
UJIT  
TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË  
VERIUT



NJOFTIM PËR OPINIONIN

**Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (KRRE) i ka miratuar ndryshimet, me të cilat plotësohen rregullat e rrjetit për shpërndarjen e ngrohjes, me të cilat është paraparë rritja e kufirit të temperaturës për ndërprerjen e punës së ngrohtoreve.**

Ndryshimet kanë për qëllim rritjen e komoditetit të konsumatorëve të kyçur në sistemin e ngrohjes qendrore, të cilët në kushte pandemie janë të obliguar të qëndrojnë në shtëpitë e tyre më gjatë.

"Me ndryshimet, të cilat i kemi miratuar, praktikisht obligohet BEG-u, që në kushte kur temperatura e jashtme gjatë ditës arrin deri më 16 gradë celsius, të ketë furnizim me energji termike nëpër shtëpi. U bëj thirrje kompanive për rritje të përgjegjësisë shoqërore në gjendje pandemie. Njëashtu i informoj konsumatorët se po shqyrtohet mundësia për procedurë kundërvajtjeje për shkak të mosrespektimit të dispozitave të Ligjit të Energjetikës dhe të obligimeve të definuara me licencën e kryerjes së veprimtarisë energjetike", deklaroi Marko Bislimoski, kryetar i Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit.

Konsumatorët, të cilët janë të pakënaqur me shërbimet e distributorëve të energjisë termike mund të parashirojnë kundërshtim deri te KRRE-ja.

18.11.2020

